



ASAMBLEJA E PERGJITHSHME AKSIONERE TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA-PERIME LUSHNJË.

V E N D I M

NR. 05 DATË 20.10.2018

MBI DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E SHA "TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA PERIME"

Asambleja e Pergjithshme Aksionere Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta- Perime Lushnjë në mbledhjen e datës 20/07/2018 pasi analizoi materjalin e paraqitur nga SHA Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta- Perime Lushnjë, mbi miratimin e disa ndryshimeve në statutin e saj si dhe në mbështetje të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Per tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", në zbatim të statutit të Sha Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta- Perime Lushnjë, si dhe vendimit të keshillit mbikqyrës nr 15 date 11.06.2018 " Per ndryshimin e statutit të shoqërisë SHA Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta- Perime Lushnjë".

V E N D O S I:

I. Të miratojë ndryshimet e paraqitura në statutit SHA " Tregu i shitjes me shumicë Fruta Perime" si me poshte:

Neni 3. Objekti i shoqërisë formulohet:

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

1. Ngritja dhe funksionimi me efikasitet ekonomike të tregut të shitjes me shumicë të prodhimeve bujqësore të freskëta dhe të përpunuara.
2. Sigurimi i efikasitetit ekonomike sa më të madhe të shoqërisë dhe plotësimi i qëllimeve të saj nëpërmjet dhënies në përdorim, sipas të gjitha mënyrave të percaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vendimeve përkatëse të Këshillit Mbikqyrës, të hapsirave dhe mjediseve shërbyese të tregut për pale të treta fizike dhe juridike, që tregtojnë prodhime bujqësore të freskëta dhe të përpunuara.

3. Dhenien në përdorim sipas gjithë mënyrave të percaktuara në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vendimeve procedurale përkatëse të Këshillit Mbikqyrës, të hapsirave, mjediseve dhe shërbimeve, që sigurojnë rritjen e efektivitetit ekonomik të shoqërisë

4. Organizimin e panairëve, forumëve dhe aktiviteteve, që i shërbejnë shtimit të prodhimeve vendore dhe fuqizimit të ekonomisë vendore dhe kombëtare.

5. Shoqëria dhe palet e treta kontraktore në bashkpunim me inspektoriatet dhe agjencitë e fushës sigurojnë përmbushjen e standarteve ligjore në fuqi për sigurinë ushqimore, mjedisin, çertifikimin dhe transparencën tregtare të funksionimit të tregut.

Neni 9 Asambleja e Përgjithshme të formulohet:

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë. Ajo vendos mbi të gjitha çështjet e shoqërisë dhe vendimet e saj janë të detyrueshme për organet administruese. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për :

- 1- Ndryshime të statutit.
- 2- Emerimin e shkarkimin e anëtarëve të keshillit mbikqyrës.
- 3- Miratimin e pasqyrës financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- 4- Shpërndarjen e fitimeve vjetore.
- 5- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar.
6. Çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", të ndryshuar dhe në statut.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit mbikqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Neni 13 ndryshon si në vijim:

Këshilli Mbikqyrës ka detyrimet dhe përgjegjësitë si më poshtë:

1. Keshilli përcakton të gjitha strategjitë dhe aktivitetet tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve të percaktuara në statut dhe vendimeve të asamblese së përgjithshme.
2. Keshilli vendos për mënyrat, rregullat dhe procedurat administrative të shoqërisë për plotësimin e përgjegjësisë të percaktuara në nenin 3 të statutit, për marrëdhëniet institucionale dhe tregtare me palet e treta si dhe vezhgon zbatimin e tyre nga administratori.
3. Keshilli emeron dhe shkarkon me shumicë votash administratorin e shoqërisë.
4. Vendos për emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve.
5. Keshilli përgatit me kërkesë të asamblesë marrjen e masave që janë në përgjegjësi e asamblesë si dhe është përgjegjës për zbatimin e tyre.

6. Keshilli i kërkon dhe i paraqet asamblese marrjen e vendimeve, që vlerësohen të nevojshme për miradministrimin e shoqërisë.

7. Keshilli përcakton shpërblimin e administratorit dhe antareve të keshillit.

8. Keshilli përcakton numrin e punonjësve, strukturën administrative të shoqërisë dhe masën e shpërblimit përkatës.

9. Keshilli ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole, që ai i çmon të përshtatshme për miradministrimin e shoqërisë.

II. Ngarkohet SHA " Tregu i shitjes me shumicë Fruta Perime" për zbatimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PER ASAMBLENË AKSIONERE
KRYETARI

FATOS TUSHE



AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Sot me date 11.03.2003, ne baze te ligjit 8652, date 31.7.2001 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", Bashkia Lushnje, perfaqesuar nga Kryetari I Bashkise,

VENDOSI:

1. Bashkia si aksionere te themeloje shoqerine "Tregu I shitjes me shumice I fruta- perimeve" SHA ne perputhje me kete akt themelimi, statutin dhe ligjin shqiptar "Per shoqerite tregtare".
2. Shoqeria krijohet ne formen e shoqerise anonime ne baze te ligjit shqiptar "Per shoqerite tregtare".
3. Emri I shoqerise tregtare eshte "Tregu I shitjes me shumice I fruta- perimeve" SHA.
4. Selia e shoqerise eshte ne adresen prane "Institutit te Kerkimeve Buqesore", Lushnje, Shqiperi.
5. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj Brenda territorit te Republikes se Shqiperise . Ajo mund te hape filialet e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.
Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te percaktuar mbi 10 vjet duke filluar nga dita e regjistrimit te shoqerise ne Gjykaten e Rrethit Tirane.
6. Objekt I veprimtarise se shoqerise do te jete:
 - Ngritja dhe funksionimi I tregut te shitjes me shumice te prodhimeve bujqesore te fresketa.
 - Dhenien me qera te hapesirave dhe ambienteve te tregut me shumice individeve dhe firmave qe tregtojne prodhime bujqesore te fresketa , kryesisht fruta dhe perime.
 - Dhenien me qera te hapesirave dhe ambienteve, individeve dhe firmave qe sigurojne sherbime te ndryshme per perdoruesit e tregut me shumice , me qellim qe aktiviteti I tyre tregtar te jete sa me eficient.
 - Nxitja e shitjes se prodhimeve bujqesore locale, duke organizuar aktivitetet perkatese si panaire, ekspozita dhe promovon prodhimet locale gjate gjithe vitit.
 - Shoqeria siguron transparence per transakcionet tregtare qe zhvillohen brenda tregut me shumice. Ajo grumbullon dhe shperndan te dhena per tregun tek te gjitha palet e interesuara. Shoqeria bashkepunon ngushte me te gjitha inspektoratet perkates dhe autoritetet ekzekutive publike per te siguruar qe:
 - transakcionet qe zhvillohen ne tregun me shumice te behen ne perputhje me ligjin,
 - perdoruesit e tregut te kene licensen qe kerkon ligji dhe
 - prodhimet qe tregtohen ne treg te plotesojne te gjitha kerkesat sipas ligjit.
 - Shoqeria rregullon funksionimin e tregut me shumice nepermjet zbatimit te Rregullores se brendeshme dhe nese eshte e nevojshme bashkepunon me autoritete publike perkatese.
7. Ne castin e krijimit te shoqerise , kapitali themeltar I shlyer ne leke eshte 2000 000 (dy million) leke I ndare ne 2000 aksione me vlere nominale 1000 (nje mije) leke secili . Kontributi eshte shlyer plotesisht nga aksioneri.
8. Organet drejtuese te shoqerise jane:
Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve , qe eshte organi me I larte I shoqerise
Keshilli Mbikqyres qe administron shoqerine I perbere nga:
Agim Shehu (Kryetar)
Zalo Hoxha (anetar)



Leonard Gogu (anetar)
Gezim Sina (anetar)
Hysen Dinaj (anetar)
Skender Hasa (anetar)

Drejtoria qe administron veprimtarine e shoqerise.

Ekspertet Kontabel te shoqerise jane : Hetem Kodhel Sulaj dhe Luan Kamberi.

9. Ky akt themelimi hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.

Aksioner "Bashkia e Keshit"
Kryetari i Bashkise
Ylli MYFTIU

